# DËSHMI ARKIVI

**A-442037**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kaos në Kurbin/ Vllaznia mbetet me 10 lojtarë, arbitri zbraz tribunën dhe Laçi merr 3 pikët |
| ADRESA | `https://piranjat.al/sport/kaos-ne-kurbin-vllaznia-mbetet-me-10-lojtare-arbitri-zbraz-tribunen-dhe-la-i103981` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 06:29:37 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 06:27:44 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bec1724939cf92e371b1e66a1a80a0840f9ce5a8a76b46652fa636348e55c423` |
| TEKSTI | `27be1b8a4f70d9f7a790e528ac773af72b0553857e9bbfcf72cc5bf2b3fce49a` |
| PAMJA | `d76b1ecd2cb44a29d0d8b3edcb6eac4a2a5ef490b0fb274aa5fb90c054ed6ab9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `88a9f1ad2e32889d73a4f22217762ee0942475f243e459cdbec950b0d789c756` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/88a9f1ad2e32889d73a4f22217762ee0942475f243e459cdbec950b0d789c756`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SPORT

# Kaos në Kurbin/ Vllaznia mbetet me 10 lojtarë, arbitri zbraz tribunën dhe Laçi merr 3 pikët

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 08:27



Laçi ka mposhtur Vllazninë 2-0 në një derbi të tensionuar në Kurbin, ku ndeshja u ndërpre për shkak të incidenteve në tribuna dhe përfundoi pas plot 110 minutash lojë.

Kuqeblutë mbetën me 10 lojtarë, ndërsa arbitri Kreshnik Cjapi urdhëroi zbrazjen e një sektori të stadiumit përpara rifillimit të takimit.

Ndeshja nisi me ritëm të lartë, me Vllazninë që krijoi rrezik që në minutën e parë përmes Mustës. Shkodranët patën më shumë kontroll të topit, ndërsa Laçi kërkoi hapësirat në kundërsulm.

Tensioni u shfaq që në pjesën e parë, kur një përplasje në fushë përfshiu edhe pankinat dhe loja u ndërpre për rreth dy minuta.

Pjesa e parë u mbyll pa gola, por ritmi dhe tensioni u rritën pas pushimit. Në minutën e 50-të, Laçi gjeti golin e avantazhit. Traore zbriti shpejt dhe pas aksionit topi përfundoi te Cena, i cili me një goditje të saktë mposhti portierin Avram për 1-0.

Momenti që ndryshoi ndeshjen erdhi në minutën e 71-të. Mehmeti i Vllaznisë u ndëshkua me karton të kuq të drejtpërdrejtë, vendim që solli protesta nga lojtarët shkodranë dhe drejtori sportiv Vioresin Sinani. Situata u tensionua më tej kur nga tribuna u hodh një send në drejtim të fushës.

Arbitri Kreshnik Cjapi ndërpreu ndeshjen dhe kërkoi që sektori problematik të boshatisej plotësisht përpara se loja të vazhdonte. Pas rreth 11 minutash ndërprerje, futbollistët u rikthyen në fushë dhe takimi rifilloi në minutën e 88-të.

Por Laçi nuk vonoi të godiste sërish. Vetëm pak çaste pas rifillimit, një harkim i Azizit gjeti Traoren në shtyllën e dytë dhe sulmuesi realizoi golin e dytë në minutën e 89-të, duke i dhënë skuadrës vendase avantazhin 2-0.

Për shkak të ndërprerjes së gjatë, u akorduan 19 minuta shtesë, duke e çuar kohën totale të ndeshjes në rreth 110 minuta. Vllaznia pati një mundësi të artë me Balajn në minutën e 90'+4, por ai nuk arriti të shënonte përballë portierit Guri.

Në fund, Laçi mori tri pikët në një nga ndeshjet më të tensionuara të javës së katërt të Abissnet Superiore, ndërsa Vllaznia u largua nga Kurbin pa pikë dhe me një lojtar më pak.

## Artikuj te sugjeruar

SPORT 13 Shtator23:55

**“Shpresojmë të jetë një fillim i mirë”/ Allegri pas fitores së Napolit: Kemi dhënë pak raste**

Napoli rikthehet te fitorja në kampionat. Skuadra e drejtuar nga Massimiliano Allegri mposhti Bolognan me rezultatin 1-0, duke i dhënë fund se...

SPORT 13 Shtator23:31

**Manchesteri ngjyroset blu/ City fiton derbin me 10 lojtarë, Haaland mposht United**

Manchester City ka fituar derbin e Manchesterit në transfertë, duke mposhtur Manchester United 1-0 në Old Trafford. Skuadra e Enzo Maresca-s l...

SPORT 13 Shtator22:57

**Pak orë pas golit të fitores, Daniel Maldini përfshihet në aksident/ Rezultoi pozitiv në testin e alkoolit**

Daniel Maldini, futbollisti i Cagliarit dhe djali i legjendës së Milanit, Paolo Maldini, është përfshirë në një akside...

SPORT 13 Shtator22:49

**"Çmendet" Zhegrova në fund/ Dopietë me Juventusin, por Sassuolo i prish festën**

Edon Zhegrova ishte protagonist i minutave të fundit në përballjen mes Sassuolos dhe Juventusit, por dopieta e tij nuk mjaftoi për të...

SPORT 13 Shtator21:27

**Tottenham në krizë me De Zerbin/ Asnjë fitore dhe asnjë gol në 4 ndeshje**

Tottenham po kalon një start të vështirë të sezonit, pavarësisht investimit prej rreth 300 milionë eurosh në merkaton ...

SPORT 13 Shtator21:19

**Formula 1/ Antonelli fiton edhe në Madrid, shkëputet në garën për titullin**

Kimi Antonelli ka fituar edhe Çmimin e Madh të Spanjës në Madrid, duke marrë fitoren e tetë të sezonit dhe duke rritur nd...

SPORT 13 Shtator21:11

**Egnatia nuk është e pamposhtur/ Elbasani fiton 2-1 dhe i shkakton rrogozhinasve humbjen e parë**

Elbasani ka marrë tri pikë të rëndësishme në shtëpi, duke mundur Egnatian me rezultatin 2-1 në javën e katër...

SPORT 13 Shtator18:37

**Forcë e frikshme, Fernando Torres regjistron rezultatin 970 në makinetën e boksit**

Ish-sulmuesi legjendar i kombëtares spanjolle, Fernando Torres, ka vërtetuar edhe një herë se vazhdon të gëzojë një fo...

SPORT 13 Shtator18:35

**Fillimi katastrofik i sezonit Valencia shkarkon Drejtorin Sportiv dhe trajnerin**

Valencia e ka nisur në mënyrë katastrofike sezonin e ri në La Liga. Pas 5 javëve të para të kampionatit, skuadra valenciane...

SPORT 13 Shtator18:26

**Barcelona dhuron sërish spektakël, mund Levanten dhe ruan me pikë të plota kreun e La Ligës**

Barcelona ka marrë një tjetër fitore në La Liga, duke mposhtur Levanten me rezultatin 2-4 në transfertë, në një ndeshj...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

**"Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...**

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melburni drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

**"Dil jashtë", u përplas me Edi Ramën për "Terri...**

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

BOTA 13 Shtator

**A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një lufte t...**

Lufta mes SHBA-së dhe Iranit ka zgjatur shumë më tepër nga sa pritej, por pavarësisht tronditjeve, tregu global i naftës ka tregua...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik]

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video




## Reagon Cllevio!






**Reagon Cllevio!**



**Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!**





**Deklarata e Gjestit!**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.